

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Berlini do të dërgojë deri në 1,000 trupa në Lituani, NATO forcon mbrojtjen ndaj kërcënimit rus
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/berlini-do-te-dergoje-deri-ne-1000-trupa-ne-lituani-nato-forcon-mbrojtjen-ndaj-kercenimit-rus/1011079/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:44:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:39:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1971247f8b54bb1b782cae85881718d05f75ca795a799cacacfb759398426f9
TEKSTI	c45f5c78ef31ab9b0aa09b20579a474b86e1f90be628a8a5ad6f54cffc54cb9f
PAMJA	7b9336c0a5fe78b4393395cf01cbe6e12950dda4da58c732e80eed7d38ee3f25

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e1f776ff413973685488a0ee730fd6ec38723f5030bf79187a70e393271e4622
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e0b9829abb6e6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67ff94e9a06c82fe2c5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e1f776ff413973685488a0ee730fd6ec38723f5030bf79187a70e393271e4622>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Berlini do të dërgojë deri në 1,000 trupa në Lituani, NATO forcon mbrojtjen ndaj kërcënimit rus



Gjermania planifikon të dislokojë këtë vjeshtë deri në 1,000 ushtarë aktivë në Lituani, si pjesë e brigadës së përhershme gjermane që po ngrihet atje. Kjo lëvizje vjen në kuadër të përpjekjeve të NATO-s për të përfunduar krahun lindor përballë një kërcënimi të mundshëm nga Rusia.

Sipas gazetës "Bild", ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, ka dhënë miratimin për caktimin e detyrueshëm të një pjese të personelit të Bundeswehr-it, pasi numri i vullnetarëve nuk ka mjaftuar për të plotësuar nevojat e brigadës.

Dislokimet e para mund të fillojnë gjatë vjeshtës dhe do të përfshijnë më pak se 1,000 trupa. Ky vendim nuk lidhet me një mobilizim të përgjithshëm dhe as me rikthimin e shërbimit të detyrueshëm për civilët. Ai prek vetëm ushtarët aktivë të Bundeswehr-it, të cilët mund të caktohen në Lituani edhe pa u regjistruar vullnetarisht për këtë mision.

Deri tani, rreth 60% e vendeve të punës në brigadë janë mbushur përmes vullnetarëve. Vështirësitë më të mëdha janë hasur në rekrutimin e specialistëve të IT-së, personelit të logjistikës, kuzhinierëve dhe pushkatarëve.

"Bild" raporton se caktimi i detyrueshëm mund të prekë aktualisht deri në 20% të pozicioneve të brigadës. Objektivi i Bundeswehr-it është që kjo shifër të zbresë në rreth 10% deri në fund të shtatorit, përmes përpjekjeve për të tërhequr më shumë vullnetarë.

Për të nxitur rekrutimin, ushtria gjermane ka zhvilluar fushata informuese dhe ka organizuar vizita njohëse në Lituani për ushtarët dhe familjarët e tyre. Megjithatë, për shkak të kohës së kufizuar, personeli i caktuar në mënyrë të detyrueshme duhet të njoftohet zyrtarisht dhe të ketë të drejtën ta kundërshtojë vendimin në rrugë ligjore.

të fundit /



Berlini do të dërgojë deri në 1,000 trupa në Lituani, NATO forcon...



21 viktima nga përplasja e dy minibusëve në Afrikë...



Ndahet nga jeta babai i Andy Burnham pas betejës me Alzheimer...



Dhimbje e madhe për Genta Ismajlin, këngëtarja humb një...



Rrëfimi tronditës i infermieres shtatzënë: humbi foshnjën gjatë...



Mickoski: Ulja e çmimeve të karburantit u ka kursyer qytetarë...



Kryeministri britanik në zi, ndahet nga jeta babai i tij i prekur nga...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

ngjere.

Plani i Gjermanisë parashikon vendosjen e përhershme në Lituani të 4,800 ushtarëve dhe rreth 200 punonjësve civilë deri në fund të vitit 2027. Brigada e 45-të e Blinduar Lituanëze do të jetë njësi e parë luftarake gjermane e stacionuar përgjithmonë jashtë territorit të vendit që prej krijimit të Bundeswehr-it në vitin 1955.

Kur të arrijë kapacitetin e plotë operacional, brigada pritet të përbëhet nga rreth 5,000 trupa dhe afërsisht 2,000 automjete ushtarake. Ajo është pjesë e strategjisë së NATO-s për forcimin e mbrojtjes në lindje, pas pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022.

Litania ka kufi me Bjellorusinë dhe enklavën ruse të Kaliningradit. Ajo ndodhet gjithashtu pranë Korridorit Suwalki, i cili lidh Poloninë me shtetet baltike dhe shihet si një pikë veçanërisht e ekspozuar në rast të një përplasjeje me Rusinë.

Vendimi i Berlinit është marrë në një periudhë kur edhe Polonia po shton masat e sigurisë, pas disa incidenteve të ndodhura pranë kufirit të saj.

Të dielën, më 13 shtator, një dron rus goditi motorin e një treni pasagjerësh që po udhëtonte nga Kievi drejt Varshavës. Ngjarja ndodhi në stacionin Yahodyn, në rajonin Volyn të Ukrainës, pranë kufirit me Poloninë.

Gjatë sulmit, Polonia aktivizoi avionët e saj luftarakë. Ndërkohë, kryeministri Donald Tusk thirri një mbledhje urgjente ku morën pjesë ministrat, komandantët e lartë ushtarakë dhe drejtuesit e shërbimeve të inteligjencës.

Tusk deklaroi se javët dhe muajt në vijim mund të karakterizohen nga një shtim i aktivitetit rus. Ai shtoi se nuk mund të përjashtohet mundësia që përshkallëzimi të prekë edhe territorin polak.

Sipas kreut të qeverisë polake, veprimet e Rusisë po shndërrohen në një problem të drejtpërdrejtë sigurie për vendet anëtare të NATO-s që kufizohen me Ukrainën. Kjo situatë po rrit trysinë për forcimin e gatishmërisë ushtarake në Evropë.

Shtuar më 14.09.2026 16:39



Shtypja shtetërore në Rusi zgjerohet, qindra të mitur përballen me akuza për...



21 viktima nga përplasja e dy minibusëve në Afrikën e Jugut



Ndahet nga jeta babai i Andy Burnham pas betejës me Alzheimerin,...



Kryeministri britanik në zi, ndahet nga jeta babai i tij i prekur nga Alzheimeri



SHBA i dërgon paralajmërim Serbisë për afrimin me Kinën në...



Trump i bën thirrje Ukrainës të mos godasë më objektet ruse të naftës



Vandalizëm ndaj statujës së Charlie Kirk në Phoenix, autorët ende të...



CDU kryeson zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme, AfD ngjitet në...

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Qiranat

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.